



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ .2019

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 350, DATË 19.04.2017, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE
SHTESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË MBROJTJES
NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.10405, datë 24.03.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të ndryshuar, të nenit 31, pika 1, shkronja "a" dhe pika 2 e ligjit nr.152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.350, datë 19.04.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", shtohet togfjalëshi "në strukturat e Policisë së Shtetit".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I BRENDSHËM

SANDËR LLESHAJ

MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.350, DATË 19.04.2017, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE
SHITESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË MBROJTJES
NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN"

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektvendim ka si qëllim bërjen e një ndryshimi në miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave për gradë për punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin sipas hierarkisë së gradave dhe niveleve në të cilat janë të përfshira gradat e tyre, lidhur me vjetërsinë e punonjësve të këtij shërbimi në strukturat e Policisë së Shtetit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Në zbatim të ligjit nr.10405, datë 24.03.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të ndryshuar dhe të ligjit nr.152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.350, datë 19.04.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin".

Gjatë zbatimit të këtij akti ka rezultuar se në të nuk është parashikuar vjetërsia e shërbimit të punonjësve aktualë të MZSH-së, në strukturat e Policisë së Shtetit. Miratimi i këtij projektvendimi është parashikuar në programin Projekt programi i Përgjithshëm Analitik i Projekt akteve për vitin 2018.

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për një ndryshim në vendimin nr.350, datë 19.04.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin"

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHMËRITË

Referuar dispozitave të ligjit nr.152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, dhe specifikisht nenit 31 të tij është përgatitur projektvendimi për një ndryshim në VKM nr.350, datë 19.04.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

Në pikën 3 të VKM-së nr.350, datë 19.04.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” konstatohet mos përfshirja si vjetërsi shërbimi të viteve të punonjësve të shërbimit të MZSH-së, në strukturat e Policisë së Shtetit, e cila ka qenë e parashikuar në draftin e propozuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Strukturat e shërbimit të MZSH-së deri në vitin 2001 kanë qenë në përbërje të strukturave të ish Ministrisë së Rendit (policisë) dhe mos përfshirja e kësaj periudhe si vjetërsi shërbimi, penalizon shumë punonjës, si përfitues të shtesës mbi pagë, për çdo vit vjetërsi shërbimi, në masën 1 për qind, e cila sipas vendimit të miratuar, llogaritet mbi vlerën e pagës bazë të gradës “Asistent zjarrfikës”.

Përfitues të shtesës mbi pagë të vjetërsisë së shërbimit të viteve të punonjësve të shërbimit të MZSH-së, në strukturat e Policisë së Shtetit e përfitojnë të gjitha shërbimet me uniformë dhe sistem gradash, pra Forcat e Armatosura në Republikën e Shqipërisë, Policia e Shtetit, Policia e Burgjeve, Grada e Republikës, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, Shërbimi Informativ i Shtetit, si dhe duke konsideruar faktin që përfshirja si vjetërsi shërbimi të viteve të punonjësve të shërbimit të MZSH-së, të qëndrimit në gradë në strukturat e Policisë së Shtetit, përbën detyrim ligjor.

Ndërmarrja e nismës, nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Ministri i Financave, në cilësinë e ministrave propozues, duhej ti barazonte punonjësit e shërbimit të MZSH-së në këtë aspekt me punonjësit e shërbimeve e tjera, të cilët tashmë janë përfitues të kësaj të drejte.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është hartuar në mbështetje të:

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr.350, datë 19.04.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

Nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligjit nr.10405, datë 24.03.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve". Në bazë të këtij ligji Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit që mbulon Departamentin e Administratës Publike dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë miraton strukturën e pagave për nëpunësit/punonjësit e administratës publike, qendrore dhe vendore, për të cilët kjo strukturë nuk është e shprehur në ligjet specifike.

Ligji nr. 152, datë 21.12.2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin". Në bazë të këtij ligji parashikohet që pagat e punonjësve të këtij shërbimi rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon përafrimin e ndonjë *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim propozohet nga Ministri i Brendshëm dhe Ministri i Financave dhe Ekonomisë.

Propozimi konsiston në ndryshimin e pikës 3 të VKM-së nr.350, datë 19.04.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", duke shtuar në këtë pikë edhe togfjalëshin "në strukturat e Policisë së Shtetit".

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e vendimit ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe bashkitë përkatëse.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për një ndryshim në vendimin nr.350, datë 19.04.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin"."

Ky projektvendim është hartuar nga Drejtoria e shërbimit të MZSH-së, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Brendshme dhe është bashkërenduar me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

PROPOZUESIT

MINISTRI I BRENDSHËM MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË

SANDËR LLESHAJ

ANILA DENAJ

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për një ndryshim në vendimin nr.350, datë 19.04.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin"".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ . 2019

PËR

“DHËNIEN NDIHMËS SË MENJËHERSHME FINANCIARE TË
PUNONJËSIT TË SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI
DHE SHPËTIMIN, NË RAST TË DËMTIMIT TË RËNDË TË
PRONËS, PËR SHKAK TË DETYRËS”

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1/c të nenit 31 të ligjit nr.152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave:

VENDOSI:

1. Punonjësit të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në vijim MZSH-së, në rast të dëmtimit të rëndë të pronës për shkak të detyrës, përfiton ndihmë të menjëhershme financiare në masën 100 për qind të vlerës së pronës së dëmtuar, por jo më shumë se 1.000.000 lekë.
2. Përfiton ndihmë të menjëhershme financiare, sipas pikës 1 të këtij vendimi, punonjësi i shërbimit të MZSH-së të cilit i është shkaktuar dëmtim i rëndë ndaj pronës së paluajtshme, dëm që vlerësohet më shumë se 100.000 lekë.
3. Për të përfituar ndihmë të menjëhershme financiare, punonjësi i shërbimit të MZSH-së duhet të mbajë titull pronësie, bashkëpronësie apo në proces legalizimi të pronës së dëmtuar.

4. Punonjësit të shërbimit të MZSH-së i jepet ndihmë e menjëhershme financiare, sipas këtij vendimi, vetëm në rast se nuk ka përfituar dëmshpërblim për dëmtimin e pronës nga shoqëritë e sigurimit, sipas përcaktimeve të ligjit nr.52/2014 “Për Veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit”.
5. Përfiton ndihmë të menjëhershme financiare punonjësi i shërbimit të MZSH-së të cilit:
 - a) prona i është dëmtuar si pasojë e veprës penale, kryer në dëm të punonjësit të shërbimit të MZSH-së për shkak të detyrës, dhe për rastin është referuar materiali në Prokurori.
 - b) Dëmtimi i pronës i është shkaktuar gjatë përdorimit të saj nga punonjësi i shërbimit të MZSH-së për përmbushjen e detyrave zyrtare.
6. Për përfitimin e ndihmës së menjëhershme financiare, sipas pikës 1 të këtij vendimi, punonjësi i shërbimit të MZSH-së i kërkon zyrtarisht titullarit të strukturës ku ai shërben, ku parashton faktin e dëmtimit dhe dorëzon dokumentacionin që kërkohet sipas këtij vendimi.
7. Ministri i Brendshëm, për punonjësit e shërbimit të Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së dhe Kryetari i Bashkisë për punonjësit e shërbimit të MZSH-së në nivel vendor urdhërojnë ngritjen e komisionit të verifikimit të faktit dhe vlerësimin e dëmit të shkaktuar, dhe ky urdhër i komunikohet punonjësit të shërbimit të MZSH-së që ka kërkuar ndihmë të menjëhershme financiare.
8. Komisioni për verifikimin e faktit dhe vlerësimin e dëmit drejtohet nga Drejtori i MZSH-së për punonjësit e shërbimit të MZSH-së në nivel qendror dhe nënkryetari i bashkisë në nivel vendor dhe përbëhet nga 5 anëtarë, specialistë të fushës.
9. Komisioni verifikon faktin e dëmtimit të pronës, bën vlerësimin paraprak të dëmit të shkaktuar dhe shikon përputhshmërinë me kriteret për përfitimin e ndihmës së menjëhershme financiare, dhe jo më vonë së 10 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës së punonjësit të shërbimit të MZSH-së. Komisioni vë në dispozicion të titullarëve të përcaktuar në pikën 7 të këtij vendimi përfundimet e arritura.
10. Pagesa për ndihmë të menjëhershme financiare për dëmin e shkaktuar bëhet me urdhër të Ministri i Punëve të Brendshme, për punonjësit e shërbimit të Drejtorisë së Përgjithshme dhe të Kryetarit të Bashkisë për punonjësit e shërbimit të MZSH-së në nivel vendor.

11. Bashkëlidhur urdhit të Ministri i Punëve të Brendshme ose të Kryetarit të Bashkisë në çdo rast duhet të jenë:
- a) kërkesa më shkrim e punonjësit të shërbimit të MZSH-së që përfiton ndihmën;
 - b) kopje e njësuar me origjinalin e shkresës për referim të veprës penale procedurale të prokurorisë, ose procesverbali që evidenton ngjarjen aksidentale;
 - c) dokumentacioni që provon titullin e pronësisë të punonjësit të MZSH-së mbi pronën e dëmtuar.
 - d) procesverbali i hartuat nga komisioni, si dhe çdo dokument i prodhuar apo i administruar nga komisioni për verifikimin e faktit dhe vlerësimin e dëmit.
12. Kur nga hetimi apo gjykimi i çështjes provohet se dëm i shkaktuar nuk ka ardhur për shkak të detyrës, punonjësi i MZSH-së, që ka përfituar ndihmë të menjëhershme është i detyruar të kthejë në masën 100 për qind shumën e përfituar.
13. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Punëve të Brendshme për punonjësit e shërbimit të MZSH-së të Drejtorisë së përgjithshme të MZSH-së dhe nga buxheti i bashkisë për punonjësit e shërbimit të MZSH-së në nivel vendor.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I BRENDSHËM

SANDËR LLESHAJ

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

PËR

“DHËNIEN NDIHMËS SË MENJËHERSHME FINANCIARE TË PUNONJËSIT TË SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN, NË RAST TË DËMTIMIT TË RËNDË TË PRONËS, PËR SHKAK TË DETYRËS”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Sigurimin e ndihmës së menjëhershme financiare punonjësit të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, kur i dëmtohet prona për shkak të detyrës.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi i Këshillit të Ministrave është i mbështetur në Programin Politik të Këshillit të Ministrave për vitin 2016, si dhe del në zbatim të pikës 2 të nenit 18 të Ligjit 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky projekt është i domosdoshëm pasi i vjen në ndihmë punonjësit të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, pjesë e një strukture e specializuar e gatishmërisë së përhershme në përmbushje të misionit i këtij shërbimi, gjatë inspektimeve, parandalimit, të masave të mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrjes për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe

kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

Dhënia e ndihmës financiare nga ana e shtetit është formë e mbështetjes dhe një garanci për punonjësin e shërbimit zjarrfikës, për moscenimin e cilësisë së jetës, së tij dhe familjes, në rastet kur prona e tij dëmtohet rëndë për shkak të detyrës apo gjatë kryerjes së saj.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projekt është në përputhshmëri e në harmoni me gjithë rendin juridik të brendshëm.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në këtë projektvendim është përcaktuar dhënia e ndihmës financiare të menjëhershme, në rastet e dëmtimit të rëndë të pronës për punonjësin e MZSH-së për shkak të detyrës, nuk lidhet me ngritjen e padisë civile për zhdëmtimin e dëmit nga vepra penale.

Konsiderohet dëmtim i rëndë i pronës, kur vlera e dëmit të shkaktuar është jo më pak se 100.000 lekë.

Dhënia e ndihmës do të kryhet sipas përcaktimit të aktit të vlerësimit të nxjerrë nga një komision i posaçëm, i cili ngrihet me urdhër të Ministrit të Punëve të Brendshme për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së dhe nga Kryetari i Bashkisë për punonjësit e MZSH-së në nivel vendor. Komisioni duhet që të vlerësojë dëmin brenda 10 ditëve pune nga kërkesa e punonjësit të MZSH-së që i është dëmtuar prona.

Punonjësi i MZSH-së përfiton ndihmë në masën 100 % të vlerës së dëmit të shkaktuar, por kjo shumë nuk duhet të kalojë shumën 1.000.000 lekë.

Institucioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ai i bashkisë fillon procedurat për dhënien e ndihmës financiare, menjëherë pas kërkesës që bëhet nga punonjësi i MZSH-së të cilit i është dëmtuar prona.

Ndihma e menjëhershme financiare nuk përfitohet në rastet kur punonjësi i MZSH-së është zhdëmtuar nga shoqëri sigurimi, si dhe kthen në masën 100 % të vlerës së ndihmës financiare, kur verifikohet që vepra penale nga e cila ka ardhur dëmtimi, nuk ka lidhje me ushtrimin e detyrës së punonjësit të MZSH-së, apo të jetë si pasojë e saj.

Për të përfituar ndihmë të menjëhershme financiare, punonjësi i MZSH-së duhet të mbajë titull pronësie, bashkëpronësie apo të vërtetojë zyrtarisht që prona e dëmtuar është në proces legalizimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ministria e Punëve të Brendshme dhe bashkitë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së dhe Ministria e Punëve të Brendshme

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projekt vendim nuk ka efekte financiare pasi shpenzimet për dhënie ndihme të menjëhershme financiare punonjësit të MZSH-së kur i dëmtohet prona për shkak të detyrës do të përballohen nga fondi i veçantë i institucioneve buxhetore, i cili krijohet çdo vit në masën 5 % të fondit të pagave.

PROPOZUESI:

MINISTRI I BRENDSHËM

SANDËR LLESHAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____

PËR

SIGURIMIN E JETËS SË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË
MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 32, të ligjit nr.152, datë 21.12.2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", dhe të ligjit nr.52/2014, "Për Veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Institucioni i bashkisë siguron jetën e punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga aksidentet gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj.
2. Punonjësit të cilët përfitojnë sigurim jete janë vetëm punonjësit që kryejnë funksione operuese.
3. Sigurimi i jetës realizohet nëpërmjet lidhjes së kontratës së sigurimit të jetës me kompaninë e sigurimeve, të përzgjedhur sipas rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, "Për prokurimin publik".
4. Kontrata e sigurimit të jetës së punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga aksidentet gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj, mbulon për çdo ngjarje aksidentale, si më poshtë:
 - a) Humbjen e jetës;

- b) Paaftësinë e përhershme, të plotë ose të kufizuar;
 - c) Paaftësinë e përkohshme, të plotë ose të kufizuar;
 - ç) Shërbimet spitalore dhe/ose mjekësore.
5. Shuma për çdo punonjës të siguruar, e përcaktuar në formularin e kontratës së sigurimit, nuk mund të jetë më e ulët se 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë dhe jo më i lartë se 5 000 000 (pesë milion) lekë.
 6. Tarifa e primit të sigurimit përcaktohet në kontratën e sigurimit nga institucioni i bashkisë dhe shoqëritë e sigurimit sipas dispozitave të ligjit nr.52/2014, “Për Veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit”.
 7. Kushtet standarde të kontratës së sigurimit, përfshirë tabelën e koeficienteve të përfitimit ndaj dëmtimeve trupore, të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, shërbejnë si kushte minimale, të detyrueshme për t’u zbatuar nga shoqëritë e sigurimeve, për sigurimin e punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për efekt të këtij vendimi.
 8. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, planifikohen çdo vit në programin buxhetor për pushtetin vendor për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin dhe përballohen nga buxheti i bashkive përkatëse.
 9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkitë përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2020.

K R Y E M I N I S T R I

E D I R A M A

MINISTRI I BRENDSHËM
SANDËR LLESHAJ

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR SIGURIMIN E JETËS TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projekt vendimi “Për sigurimin e jetës të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, ka për qëllim përcaktimin e detyrimit të institucionit të bashkisë të bëjë sigurimin e jetës së punonjësit të shërbimit të MZSH-së nga aksidentet që verifikohen gjatë ndërhyrjes për shuarjen e zjarreve apo për shpëtimin në raste fatkeqësish të tjera, në zbatim të nenit 32 të ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

Gjithashtu, projekt-akti synon përcaktimin e rregullave në bazë të të cilave do të realizohet sigurimi i jetës së punonjësit të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projekt vendimi është parashikuar në programin analitik të projektakteve, për vitin 2016 për Ministrinë e Punëve të Brendshme.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për sigurimin e jetës të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”

Detyrimi ligjor për miratimin e këtij projekt-akti është parashikuar në nenin 32 të ligjit nr.152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”. *Kjo dispozitë parashikon shprehimisht se:*

“Punonjësi i shërbimit të MZSH-së përfiton sigurim jete, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Para miratimit të ligjit të lartpërmendur, në asnjë dispozitë ligjore nuk parashikohej sigurimi i jetës së punonjësit të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin. Ligji i shfuqizuar nr. 8766, datë 05.04.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin” parashikonte vetëm përfitime suplementare për punonjësin e shërbimit të MZSH-së duke i njësuar me ato të punonjësve të Policisë së Shtetit. Kështu që, aktualisht punonjësve të shërbimit të MZSH-së dhe pjesëtarëve të familjeve së tyre u njihen vetëm përfitime suplementare sipas parashikimeve të bëra në nenin 4 të ligjit nr.8661/2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”.

Sipas projekt-aktit që paraqitet për miratim, punonjësi i shërbimit të MZSH-së është personi që përfiton nga sigurimi shumë e caktuar në kontratë, në rastet kur verifikohet ngjarja e sigurimit.

Miratimi i këtij projekt vendimi do të shoqërohet me efekte pozitive pasi sigurimi i jetës do të bëjë punonjësit e shërbimit të MZSH-së më të motivuar dhe më të inkurajuar në kryerjen e detyrave me rrezikshmëri të lartë.

Sigurimi i jetës do të bëhet në bazë të kontratave tip të sigurimeve, të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Referuar këtyre kontratave dhe sipas këtij projekt vendimi, sigurimi i jetës do të përfshijë rastin e dëmtimeve trupore që mund të sjellin paaftësi të përkohshme apo të përhershme (të plotë ose të kufizuar), si edhe rastin e humbjes së jetës gjatë kryerjes së shërbimit të MZSH-së apo për shkak të tij. Rastet e mësipërme duhet të jenë shkaktuar pa vullnetin e punonjësit të shërbimit të MZSH-së dhe duhet të jenë pasojë e një aksidenti gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj.

Nuk konsiderohen raste të sigurimit sëmundjet apo çrregullimet shëndetësore që nuk vijnë si pasojë e kryerjes së shërbimit të MZSH-së.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projekt vendimi është hartuar në përputhje me Kushtetutën, në zbatim të nenit 32 të Ligjit nr.152, datë 21.12.2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” dhe është në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi.

Projektakti nuk tejkalon kufijtë e ligjit, zgjedhja e organit publik është bërë për të arritur objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të Kodit të Procedurave Administrative. Zgjidhja nëpërmjet këtij akti nuk përbën shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMbledhje SHpjeguese e PËRmbajtjes së PROJEKTAKTIT

Në pikën 1 të projekt vendimit, përcaktohet detyrimi i institucionit të bashkisë, për të siguruar jetën e punonjësve të MZSH-së nga ngjarje aksidentale gjatë kryerjes së detyrës apo për shkak të saj.

Pika 2 e projekt-aktit përcakton se kategoria e punonjësve që do të përfitojnë sigurim jete është kategoria e punonjësve që kryejnë funksione operuese. Kërcënimi i shëndetit apo jetës, si edhe rrezikshmëria e lartë që paraqitet në kryerjen e funksioneve operuese, bën të nevojshëm sigurimin e jetës së kësaj kategorie.

Pika 3, parashikon se sigurimi i jetës së punonjësve të shërbimit të MZSH-së, realizohet nëpërmjet kontratave të sigurimit, që institucioni i bashkisë do të lidhë, në dobi të punonjësit, me kompaninë e sigurimit. Përzgjedhja e kompanisë së sigurimit do të bëhet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 9646, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në pikën 4, është përcaktuar se kontrata e sigurimit të jetës së punonjësve të shërbimit të MZSH-së mbulon për çdo ngjarje aksidentale si më poshtë:

- a) humbjen e jetës;
- b) paaftësinë e përhershme, të plotë ose të kufizuar;
- c) paaftësinë e përkohshme, të plotë ose të kufizuar;
- d) shërbimet spitalore dhe/ose mjekësore.

Ky parashikim është bërë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimi dhe risigurimit”, që parashikojnë klasat e përfshira në veprimtarinë e sigurimit të jetës.

Në pikën 5 të projekt-aktit është parashikuar shuma e sigurimit e cila nuk mund të jetë më e ulët se 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) lekë. Kjo shumë është përcaktuar duke u bazuar në praktika të ngjashme të sigurimit të jetës së punonjësve që kryejnë detyra që paraqesin rrezikshmëri.

Sipas këtij përcaktimi dhe referuar kontratave tip të sigurimit që aktualisht funksionojnë në tregun e sigurimeve, nëse punonjësi i shërbimit të MZSH-së humb jetën në rrethanat e përcaktuara në pikën 1, familjarët e tij do të përfitojnë një shumë sigurimi të përcaktuara në kontratën që do të lidhë institucioni i bashkisë me kompaninë e sigurimit, por shuma e përfituar nuk mund të jetë më pak se 2.500.000 lekë.

Kjo shumë do të përfitohet edhe nëse punonjësi pëson dëmtime të shëndetit që i shkaktojnë paaftësi të përhershme. Ndërsa, nëse pëson dëmtime të shëndetit që i shkaktojnë paaftësi të përkohshme do të përfitojë një pjesë të kësaj shume sipas përcaktimeve në kontratën e sigurimit, në raport me shkallën e dëmtimeve trupore dhe të paaftësisë për punë.

Në pikën 6, në versionin fillestar ishte përcaktuar se tarifa e primit të sigurimit nuk mund të jetë më e ulët se 0.5 % e shumës së siguruar në kontratën e sigurimit. Në reflektim të mendimeve të AMF-së, versioni që paraqitet për miratim ka ndryshuar dhe konkretisht, është parashikuar se, tarifa e primit të sigurimit përcaktohet në kontratën e sigurimit nga institucioni i bashkisë dhe shoqëritë e sigurimit sipas dispozitave të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Pika 7 e projekt-aktit, parashikon se kushtet standarde të kontratës së sigurimit, përfshirë tabelën e koeficienteve të përfitimit, ndaj dëmtimeve trupore të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, shërbejnë si kushte minimale, të detyrueshme për t'u zbatuar nga shoqëritë e sigurimeve, për sigurimin e punonjësve të shërbimit të MZSH-së.

Në pikën 8 të projekt vendimit, parashikohet se efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, planifikohen çdo vit në programin buxhetor për pushtetin vendor për shërbimin e MZSH-së dhe përballohen nga buxheti i bashkive përkatëse.

Pika 9 përcakton se për zbatimin e këtij projekt-akti ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe bashkitë përkatëse.

Lidhur me çështjen e limitit të sigurimit të detyrueshëm të jetës dhe aksidenteve të punonjësve operues të shërbimit zjarrfikës referojmë se:

Për sigurimin e detyrueshëm imponimi për sigurimin për limitin minimal të përgjegjësisë (referuar shembujve si sigurimi TPL-ve, Sigurimi Kufitar, Sigurimi i detyrueshëm i minatorëve, sigurimi i përgjegjësisë së karburanteve etj) është autoriteti imponues përkatës, i përcaktuar në këtë projektvendim.

Projektvendimi parashikon se, për autoritetin imponues (bashkia) është i rëndësishëm fakti që personat apo përgjegjësitetë që do të sigurohen tu garantohet një minimum mbrojtje e caktuar, e cila është konsideruar si e nevojshme në rastin konkret. Duke qenë sigurim i detyrueshëm, autoriteti imponues garanton me limitin minimal të përgjegjësisë që të parandalohen abuzimet e mundshme, që ky limit të jetë me i vogël çfarë do të cenonte interesat e personave të siguruar.

Ndërkohe limiti maksimal është një nocion që nuk përdoret në sigurimin e detyrueshëm, pasi sa më i lartë të jetë mbulimi aq më mirë është për palën e siguruar.

Referuar legjislacionit për prokurimin publik, autoriteti i qeverisjes vendore ka mundësi të përcaktojë një tarife primi maksimale, në kushtet e konkurrencës së lirë arrihet një mbulim mbi limitin minimal me të njëjtin prim të përlllogaritur apo të marr limitin minimal të përgjegjësisë për një prim me të ulët se ai të përlllogaritur.

Shuma e sigurimit në projektvendim është përcaktuar duke krahasuar me raste të ngjashme në vend ku përmendim VKM nr.1109, datë 30.07.2008 “Për sigurimin punonjësve, të punësuar në veprimtarinë minerare, nga aksidentet në punë”, si dhe VKM nr.177, datë 09.03.2016 “Për sigurimin e jetës së ushtarakëve të Forcave të Armatosura, që dërgohen në misione ushtarake jashtë vendit, për vitin 2016”, ku si raste të ngjashme përmendim sigurimin e minatorëve që kane një limit minimal përgjegjësie prej 6 000 000 (gjashtë milion) lekës apo sigurimin e jetës së ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që dërgohen në misione ushtarake jashtë vendit, ku limiti minimal është 10 000 000 (dhjetë milion) lekë nëse humbin jetën në mision dhe 5 000 000 (pesë milion).

lekë nëse humbin jetën në mënyre aksidentale (pra kur aksidenti nuk ka lidhje me misionin e tyre).

Për analogji referuar studimeve dhe vlerësimeve, të tregut aktual në fushën e sigurimeve dhe risigurimeve, dëshmipërblimi i një punonjësi zjarrfikës në rast se përfshihet në një dëm me një mjet motorik, për vlerësimin e demit shëndetësor në sigurimin e detyrueshëm qoftë me kritere tabelare qoftë me formulë përlllogaritje do të jetë:

Shembull: një punonjës zjarrfikës një page mesatare prej 60.000 lekësh në muaj demi mesatar për një person me një familje te vogël (3-4) persona shkon rreth 5-7 milion lekë. Ndërkohe nëse flasim për paaftësi totale të përhershme kjo shumë mund te shkoje 10-12 milion lekë.

Pra me pak fjale limiti maksimal i përgjegjësisë në sigurimin e detyrueshëm nuk është një koncept i përdorur, pasi institucioni i bashkisë është ai që imponon këtë sigurim.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ministria e Punëve të Brendshme dhe bashkitë përkatëse.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së dhe Drejtoria Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Në projektvendim është parashikuar, që fondi i përcaktuar për këtë qëllim, të planifikohet për çdo vit në programin buxhetor për pushtetin vendor për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.

Referuar strukturës aktuale të shërbimit të MZSH-së, duke përlllogaritur një shumë sigurimi rreth 5 mijë lekë në vit për çdo punonjës të siguruar (2.500. 000

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për sigurimin e jetës të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin"

lekë shuma e sigurimit x 0.5% primi i sigurimit = 12.500 lekë (12 mijë e pesëqind), rezulton se fondi i nevojshëm për sigurimin e jetës së punonjësve të shërbimit të MZSH-së, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë projektvendim është 12.500.000 lekë (1000 punonjës operues x 12.500 lekë/për punonjës =12.500.000 lekë).

Ky efekt financiar, do të planifikohet në Buxhetin e bashkive përkatëse për vitin buxhetor 2020 dhe për këtë qëllim, hyrja në fuqi është parashikuar me 1 janar të vitit 2020.

PROPOZUESI

MINISTRI

SANDËR LLESHAJ